



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 gusht 2024
Nr.ref.: AGJ 2520/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI272/23

Parashtrues

Ali Tahiri

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AKPA. II. nr. 163/23] të 1 nëntorit 2023, të Prokurorisë së Apelit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ali Tahiri, me vendbanim në Gjakovë, i cili përfaqësohet nga Ilir Hoxhaj, avokat (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [AKPA. II. nr. 163/23] të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria e Apelit) të 1 nëntorit 2023.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar të Prokurorisë së Apelit, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Gjykata).
6. Më 27 dhjetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi edhe Prokurorinë e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe e njoftoi për mundësinë e paraqitjes së komenteve të tyre në lidhje me kërkesën.
7. Më 28 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [Nr. GJR. KI272/23] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe me Vendimin [KSH. KI272/23] caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 9 janar 2024, Prokuroria e Apelit dorëzoi komente në Gjykatë në lidhje me kërkesën.
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 30 prill 2024, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese, dhe njëzëri rekomandoi që shqyrtimi i kërkesës të shtyhet për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
11. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi që, njëzëri të (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktvendimi [AKAP. II. nr.136/23] i Prokurorisë së Apelit, i 1 nëntorit 2023, nuk është në përputhshmëri me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe (iii) të shpallë, të pavlefshëm Aktvendimin [AKAP.II.nr.136/23] e Prokurorisë së Apelit, të 1 nëntorit 2023 dhe të kthejë çështjen në rivendosje në Prokurorinë e Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 21 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës paraqiti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) kundër të dyshuarve A.T., dhe T.K., me pretendimin se kishin kryer veprën penale të “Mashttrimit” sipas nenit 261, paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës [UNMIK/RREG/2003/25] (në tekstin e mëtejme: Kodi i Përkohshëm Penal). Parashtruesi i kërkesës, në kallëzimin e paraqitur penal pretendoi që më 22 maj 2009 kishte lidhur kontratë për shitblerje të pronës me personat A. T., dhe T. K., në vlerën prej 40.000 (dyzetmijë) euro, përkundër faktit që këta të fundit nuk ishin pronarë legjitim të pronës së paluajtshme.
13. Më 3 tetor 2023, Prokuroria Themelore përmes Aktvendimit [P/II. nr. 1162/23] e hodhi poshtë kallëzimin penal ndaj të dyshuarve A. T. dhe T. K., me arsyetimin se vepra penale për të cilën akuzoheshin kishte arritur parashkrimin absolut të ndjekjes penale. Kontrata e shitblerjes ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe të dyshuarve ishte lidhur më 22 maj 2009, në kohën kur ishte në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal. Sipas këtij kodi, për veprën penale për të cilën akuzoheshin të dyshuarit parashihej dënimi prej 6 muaj deri në 5 vjet burgim. Prokuroria Themelore arsyetoi: *“Ligjvënësi në nenin 90, par. 1 nënpar. 1.4 të KPK-së, ka paraparë se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret në rastet kur kanë kaluar pesë vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet burgim, gjersa konform nenit 91, par. 6 të KPK-së, ndjekja penale ndërpritet në çdo rast pasi të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit. Andaj, bazuar në faktin se dënimi i kanosur për këtë vepër penale është prej 6 muaj deri në 5 vjet dhe nga koha kur pretendohet se është kryer kjo vepër penale, 22.05.2009, e deri në paraqitjen e kallëzimit penal kanë kaluar më tepër se katërmëdhjetë (14) vite”.*
14. Më 23 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore paraqiti ankesë në Prokurorinë e Apelit. Parashtruesi i kërkesës theksoi se kontrata e lidhur ndërmjet tij dhe të dyshuarve ishte e vitit 2016 dhe dallonte nga kontrata e lidhur në vitin 2009. Rrjedhimisht, sipas tij duhej të zbatoheshin dispozitat e Kodit Nr.04/L-82 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK). Sipas parashtruesit të kërkesës: *“nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike gjegjësisht gjendja e fakteve, i dëmtuari është përshkruar në detaje se si dhe në çfarë kohe është vënë në mashtrim, si dhe janë bashkëngjitur provat materiale, prokuroria në mënyrë të gabuar ka vlerësuar gjendjen e fakteve gjegjësisht kontratën e vitit 2016, për të cilën ka konstatuar se është gabim teknik i të njëjtës ...”.*
15. Më 1 nëntor 2023, Prokuroria e Apelit përmes Aktvendimit [AKAP. II. nr. 136/23] e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pasafatshme.
16. Prokuroria e Apelit arsyetoi se bazuar në paragrafin 5 të nenit 84 (Hedhja e kallëzimit penal) të Kodit 08/L-032 të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPPK) *“i dëmtuari ose viktimi mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i njoftimit sipas paragrafit 4 të këtij neni”.*
17. Prokuroria e Apelit theksoi se *“nga shkresat e lëndës, respektivisht nga fletë kthesa rezulton se përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit, aktvendimin PP/II.nr.1162/23, të datës 03.10.2023 e ka pranuar me datën 16.10.2023 ndërsa ankesën e ka parashtruar në Prokurorinë Themelore me datën 25.10.2023, respektivisht me 2 ditë vonesë për çka edhe e njëjta është hedhur poshtë si e paafatshme”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Prokuroria e Apelit përmes aktvendimit të saj ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
19. Parashtruesi i kërkesës thekson se ankesa e tij në Prokurorinë e Apelit nuk u trajtua fare dhe gabimisht u konstatua se ankesa ishte e paafatshme. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ankesën në Prokurorinë e Apelit nëpërmjet postës me numër [5404254] e dorëzoi më 23 tetor 2023, dhe jo më 25 tetor 2023, ashtu siç pretendon Prokuroria e Apelit. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës ankesa ishte dorëzuar brenda afatit ligjor prej tetë (8) ditëve.
20. Parashtruesi i kërkesës i referohet paragrafit 1, të nenit 444 (Afatet) të KPPK-së që përcakton: *“Kur parashtresa dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo elektronike apo telegramit ose me ndonjë mjet tjetër si teleks, telefaks ose mjete të tjera të ngjashme, dita e postimit ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin që i është dërguar”*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 13

(E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE

Neni 84

Hedhja e kallëzimit penal

[...]

5. Në qoftë se Prokurori i Shtetit e ka hedhur poshtë kallëzimin penal, i dëmtuari ose viktimi mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i njoftimit sipas paragrafit 4 të këtij neni. Ankesa paraqitet në Prokurorinë e Apelit përmes prokurorisë themelore. Ankesa duhet të përmbajë faktet dhe arsyet e ankesës.

[...]

KAPITULLI XXIII AFATET

Neni 444

Afatet

2. Kur parashtrësia është e lidhur me afat, konsiderohet se është dhënë brenda afatit nëse i është dorëzuar marrësit të autorizuar para kalimit të afatit.

3. Kur parashtrësia dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo elektronike apo telegramit ose me ndonjë mjet tjetër si teleks, telefaks ose mjete të tjera të ngjashme, dita e postimit ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin që i është dërguar. Dërguesi i parashtrësës konsiderohet se nuk e ka lëshuar afatin kur personi të cilit tentohet t'i dërgohet deklarata nuk e ka marrë me kohë për shkak të gabimeve në mjetet e dërgimit për të cilat dërguesi nuk ka qenë në dijeni.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

Neni 21

[Parimet e përgjithshme]

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

23. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

24. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AKPA. II. nr. 163/23] e Prokurorisë së Apelit të 1 nëntorit 2023, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
25. Gjykata rikujton që esenca e rastit konkret ndërlidhet me atë se kallëzimi penal i paraqitur nga ana e parashtruesit të kërkesës në Prokurorinë Themelore, nga kjo e fundit ishte refuzuar për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të veprës penale. Si rezultat i ankesës së parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Prokurorisë Themelore në Prokurorinë e Apelit, kjo e fundit ankesën e tij e kishte hedhur poshtë si të pasafatshme. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të drejtës së tij për mjete juridike, të garantuar me nenin 32, në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës.
26. Gjykata rithekson se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kallëzim penal në Prokurorinë Themelore kundër dy personave A. T. dhe T. K., i cili kallëzim penal ishte refuzuar nga Prokuroria Themelore. Marrë për bazë faktin, që parashtruesi i kërkesës në këtë fazë të procedurës e konsideron veten si palë e dëmtuar nga veprimet e dy personave të tjerë, ndaj të cilëve ushtroi kallëzim penal në prokurorinë kompetente, dhe ankesa e tij në Prokurorinë e Apelit është hedhur poshtë si e pasafatshme si rezultat i përlllogaritjes së afatit nga ana e kësaj të fundit, Gjykata konsideron se në rastin konkret pretendimet e parashtruesit të kërkesës ngërthejnë elementet të së drejtës së tij për mjet juridik, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.
27. Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç përcaktohet përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e rastit

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon që aktvendimi i kontestuar i Prokurorisë së Apelit, përmes të cilit ishte hedhur poshtë ankesa e tij kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore si e paafatshme, ia mohoi atij përdorimin e mjetit juridik.

(i) Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për mjet juridik

29. Gjykata rithekson se secili person ka të drejtë të shterojë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Bazuar në nenin 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, sistemet juridike duhet të kenë në dispozicion mjete efektive juridike për

të adresuar thelbin e pretendimeve për shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës, [KI193/18](#), parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafët 129-132; [KI94/16](#), parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 24 marsit 2014, paragrafi 90; dhe [KI47/12](#), parashtrues *Islam Thaçi*, Aktgjykim i 11 korrikut 2012, paragrafi 45).

30. Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se neni 32 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së garanton qasjen në mjete juridike për të adresuar pretendimet për shkeljen e të drejtave dhe lirive, në çfarëdo forme që ato mund të kenë ndodhur (shih rastet e Gjykatës, [KI86/18](#), me parashtrues *Slavica Dorđević*, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, paragrafët 124-125; shih dhe rastet e GJEDNJ-së, [Boyle and Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9659/82, 9658/82, Aktgjykim i 27 prillit 1988, paragrafi 52).
31. GJEDNJ-ja përmes praktikës gjyqësore të saj ka theksuar se, "Autoriteti" i përmendur në nenin 13 të KEDNJ-së nuk ka nevojë, në të gjitha rastet, të jetë një institucion gjyqësor në kuptimin strikt ose të një gjykate në kuptim të neneve paragrafit 1 të nenit 6 dhe paragrafit 4 të nenit 5 të KEDNJ-së (shih, rastet e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 4451/70, Aktgjykim, i 21 shkurtit 1975; paragrafi 33; *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, nr. 5029/71, Aktgjykim, i 6 shtatorit 1978, paragrafi 67; *Rotaru kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28341/95, Aktgjykim i 4 majit 2000, paragrafi 69; *Driza kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 116). Në këtë kuptim, GJEDNJ po ashtu ka theksuar se një trupë jo-gjyqësore në parim duhet të ketë kompetencën që të nxjerrë një vendim ligjërish të detyrueshëm. Megjithatë, GJEDNJ po ashtu merr për bazë nëse (i) kompetencat e autoritetit dhe masat mbrojtëse procedurale (i) që ai autoritet ofron, merren për bazë në mënyrë që të përcaktohet nëse mjete juridik është efektiv (*Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5947/72; dhe 7 të tjerë, Aktgjykim i 25 marsit 1983, paragrafi 13; dhe (ii) të verifikojë nëse "autoritetet" jo-gjyqësore janë të pavarura (shih rastin *Leander kundër Suedisë*, nr. 9248/81, Aktgjykim i 26 marsit 1987, paragrafi 77; dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 35394/97, Aktgjykim i 12 majit 2000, paragrafët 44-47).
32. Gjykata duke afirmuar parimet e përgjithshme të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së rithekson se, neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës garanton të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (ii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iii) të drejtën për një zgjidhje efektive nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me Kushtetutë (shih, në mënyrë analoge, rastin e GJEDNJ-së, *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim, i 27 prillit 1998, paragrafi 52). Në vijim, Gjykata duke iu referuar qëndrimit të GJEDNJ-së vëren se kjo e fundit ka vënë në pah se neni 13 duhet të jetë "efektiv" si në praktikë ashtu edhe me ligj (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 27 qershorit 2000).

(ii) Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me pretendimin për shkeljen e të drejtës për mjet juridik

33. Gjykata rikujton se, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kallëzim penal në Prokurorinë Themelore kundër dy personave, me dyshimin se të njëjtit kishin kryer veprën penale të "Mashtrimit", sipas paragrafit 2, të nenit 261 nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Prokuroria Themelore e kishte hedhur poshtë kallëzimin penal të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se vepra penale për të cilën po dyshoheshin personat e lartpërmendur kishte arritur parashkrimin absolut të ndjekjes penale.

34. Parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar ankesë në Prokurorinë e Apelit kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore për hedhjen poshtë të kallëzimit penal. Sipas parashtruesit të kërkesës, vepra penale nuk ishte parashkruar dhe Prokuroria Themelore duhej ta trajtonte kallëzimin penal.
35. Gjykata vëren se, Prokuroria e Apelit si autoritet kompetent për të shqyrtuar ankesën kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore, ashtu siç përcaktohet në nenin 84 [Hedhja e kallëzimit penal] të KPPK-së, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se, bazuar në fletkthesën që e posedonte, parashtruesi i kërkesës aktvendimin e Prokurorisë Themelore e kishte pranuar më 16 tetor 2023, përderisa ankesën e tij në Prokurorinë e Apelit e kishte dorëzuar më 25 tetor 2023, përkatësisht dy ditë (2) jashtë afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 84 (Hedhja e kallëzimit penal) të KPPK-së.
36. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston në vetvete afatin 8 (tetë) ditor për dorëzimin e ankesës, afat ky i përcaktua me ligj; dhe po ashtu nuk e konteston as datën e pranimit të aktvendimit të Prokurorisë Themelore, përkatësisht datën prej kur fillon të rrjedhë afati ligjor prej 8 (tetë) ditësh për dorëzimin e ankesës. Parashtruesi i kërkesës thekson se ankesën e tij kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore e kishte dorëzuar përmes postës më 23 tetor 2023, dhe jo më 25 tetor 2023 siç pretendon Prokuroria e Apelit. Sipas parashtruesit të kërkesës, neni 444 (Afatet) i KPPK-së përcakton se kur parashtrësia dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo elektronike, dita e postimit ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin që i është dërguar. Në anën tjetër, Prokuroria e Apelit në komentet që i dorëzoi në Gjykatë, pretendon që në shkresat e lëndës nuk kishte asnjë provë që arsyeton dorëzimin e ankesës përmes postës, ndërsa në sistemin e regjistrimit të lëndëve (SMIL) është konstatuar se ankesa është dorëzuar më 25 tetor 2023.
37. Në shkresat e tij të dorëzuara në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës ka bashkëngjitur një dëshmi që tregon se ankesën në Prokurorinë e Apelit e kishte dorëzuar në postë më 23 tetor 2023. Gjykata vëren se bazuar në paragrafin 3 të nenit 444 (Afatet) të KPPK-së, kur parashtrësia dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo elektronike apo telegramit ose me ndonjë mjet tjetër si teleks, telefaks ose mjete të tjera të ngjashme, dita e postimit ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin që i është dërguar. Në këtë kuptim dhe bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar aktvendimin e Prokurorisë Themelore më 16 tetor 2023, ndërsa ankesën e kishte dorëzuar përmes postës në Prokurorinë e Apelit më 23 tetor 2023, përkatësisht brenda afatit ligjor prej 8 (tetë) ditësh të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 84 të KPPK-së.
38. Gjykata konsideron se, mënyra e pranimit dhe regjistrimit të parashtrësive është çështje e brendshme e Prokurorisë së Apelit. Megjithatë, gabimet eventuale që mund të ndodhin në lidhje me regjistrimin e parashtrësive dhe llogaritjet e gabuara të afatit të pranimit të tyre nuk mund të shkojnë në dëm të palëve dhe të rezultojnë në shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për përdorimin e mjeteve juridike.
39. Gjykata rithekson se neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës përcakton se, secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës e kishte përdorur një mjet juridik të garantuar me paragrafin 5 të nenit 84 (Hedhja e kallëzimit penal) të KPPK-së, që përcakton se nëse i dëmtuari nuk është i kënaqur me hedhjen poshtë të kallëzimit penal, i njëjti mund të paraqesë ankesë kundër atij vendimi në Prokurorinë e Apelit përmes Prokurorisë Themelore brenda tetë (8) ditësh. Megjithatë, parashtruesit të kërkesës iu mohua e drejta për përdorimin e mjetit juridik në mënyrë efektive, për shkak se

Prokuroria e Apelit nuk i trajtoi në merita pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës për shkak të llogaritjes së gabuar të afatit ligjor për dorëzimin e ankesës.

40. Në vijim të kësaj, Gjykata dëshiron të theksojë se Prokuroria e Apelit e ka juridiksionin e plotë për të vendosur në lidhje me meritat e ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe në këtë kuptim nuk e paragjykon vendimmarrjen e saj.
41. Gjykata konstaton se Aktvendimi [AKPA. II. nr. 163/23] i Prokurorisë së Apelit, i 1 nëntorit 2023 - për hedhjen poshtë të ankesës si të pasafatshme, ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për përdorimin e mjetit juridik, të garantuar me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 16 korrik 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se Aktvendimi [AKAP. II. nr.136/23] i Prokurorisë së Apelit, i 1 nëntorit 2023, nuk është në përputhshmëri me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË SHPALLË, të pavlefshëm Aktvendimin [AKAP.II.nr.136/23] e Prokurorisë së Apelit, të 1 nëntorit 2023 dhe të kthejë çështjen në rivendosje në Prokurorinë e Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;
- IV. TË URDHËROJË, Prokurorinë e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës, deri më datën 17 janar 2025 për masat e ndërmarra për zbatimin këtij Aktgjykimi;
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- VII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

